

Fëmijët dhe zhvillimi i tyre

Informacione mbi ekzaminimin për regjistrimin në shkollë (Einschulungsuntersuchung ESU)



Të nderuar prindër, të nderuar kujdestarë ligjorë,

një ndër qëllimet e rëndësishme të ekzaminimit për regjistrimin në shkollë (ERS) është:

«SHFRYTËZIMI I KOHËS PËR NJË PROMOVIM OPTIMAL»

ERS është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët dhe zhvillohet në dy hapa.

Hapi 1:

në vitin e parafundit të kopshtit, përpara datës zyrtare të hyrjes në shkollë, asistentet tona mjekësore ekzaminojnë të gjithë fëmijët në qarkun e bashkisë dhe të Landit (ekzaminimi bazë).

Fëmijët, tek të cilët është i nevojshëm kontrolli mjekësor ose diagnostikimi i nivelit gjuhësor, do të thirren të marrin pjesë në një ekzaminim shtesë.

Hapi 2:

në vitin e fundit të kopshtit do të pasojë, në rast se nevojitet, një ekzaminim i mëtejshëm.

Të gjitha rezultatet e ekzaminimit i nënshtrohen ruajtjes së fshehtësisë mjekësore.

Çfarë është ekzaminimi bazë?

Në ekzaminimin bazë do të konstatohet gjendja shëndetësore dhe niveli i zhvillimit të fëmijës. Qëllimi i këtij takimi nuk është vetëm konstatimi i «aftësisë për shkollë».

Në rast se promovimi do të jetë i nevojshëm, mbetet akoma kohë të mjaftueshme për të filluar me të.

Si zhvillohet ekzaminimi?

Ekzaminimi bazë kryhet normalisht në institucionet e kopshteve dhe zgjat rreth 45 minuta.

Ju mund ta shoqëroni fëmijën tuaj gjatë ekzaminimit. Edhe nëse ju nuk do të jeni prezent gjatë ekzaminimit, ju do të merrni gjithsesi informacione të detajuara mbi të.

Çfarë do të ekzaminohet?

Asistentja mjekësore kontrollon fushat e mëposhtme të zhvillimit të fëmijës:

- Aftësitë pamore dhe dëgjimore
- Aftësinë gjuhësore
- Aftësia e mbajtjes mend
- Aftësitë motorike
- Zhvillimi i vizatimit
- Kuptimi i numrave dhe bashkësive
- Gjatësia dhe pesha



Cilat dokumente nevojiten?

Në ditën e ekzaminimit, ju lutemi të sillni me vete dokumentet në vijim:

- **deklaratën e miratimit** të plotësuar dhe të nënshkruar
- **pyetëSORIN për prindërit ose kujdestarin ligjor** të plotësuar
- **Früherkennungsheft** për fëmijë ose **Teilnahmekarte** (paraqitja është e detyrueshme)

- nëse ju ndodhen, **raportet mjekësore** të rëndësishme mbi sëmundjet e fëmijës suaj

- për mbajtësit e syzeve:
Merrni syzat me vete

Asistentja dokumenton informacionet dhe ju do të këshilloheni mbi vaksinimet.



- **Libri i vaksinave** ose një deklaratë me shkrim, që fëmija juaj nuk është i vaksinuar (paraqitja është e detyrueshme)



Si do të njoftohet rezultati i ekzaminimit?

Ju do të merrni prej nesh një raport me shkrim, të cilin ju lutemi ta përcillni edhe te mjeku juaj pediatër.

Në rast se ju jepni miratimin tuaj, institucioni i kopshtit do të vihet në dijeni mbi rezultatet e ekzaminimit dhe sipas rastit, mbi planifikimin e masave pedagogjike promovuese.

Për më tej ju do merrni edhe një këshillues për prindër nga ne, me këshilla mbi promovimin e mëtejshëm të fëmijës suaj.

Përse na nevojiten deklaratat e miratimit?

Një bashkëpunim ndër-disiplinor është shumë i rëndësishëm për promovimin optimal të fëmijës suaj.

Që ne të kemi mundësinë e bashkëpunimit me ekspertët pedagogjikë, na nevojitet miratimi juaj.

Ne jemi këtu për ju

Landratsamt Alb-Donau-Kreis
Fachdienst Gesundheit
Schillerstraße 30
89077 Ulm

Telefon:
0731 185-1735

E-Mail:
gesundheitsamt@alb-donau-kreis.de

Internet:
<https://www.alb-donau-kreis.de/einschulungsuntersuchung>

